



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT**  
**OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN**

C.nr.252/12

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtarja Shpresa Emra, në çështjen juridike të paditësit Posta Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari S. Th nga Prizreni, kundër të paditurit S. E nga Prizreni, të cilin e përfaqëson i autorizuari av.F nga Prizreni, për borxh, vlera e kontestit 91.82€, pas mbajtjes së shqyrtimit publik kryesor me dt.21.08.2014 mori këtë

**AKTGJYKIM**

- I. **APROVOHET** kërkesë padia e paditësit dhe **OBLIGOHET** i padituri S. E nga Prizreni, që në emër të borxhit për shfrytëzimin e telefonit fix dhe shërbimeve të telefonisë së paditësit të **paguaj shumën prej 91.82€** me kamatë ligjore që nga dita e marrjes së aktgjykimit, në afat prej 15 ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit.
- II. **OBLIGOHET** i padituri që të paguaj shpenzimet procedurale .

**Arsyetim**

*Pretendimet e palëve*

Paditësi respektivisht i autorizuari i tij fillimisht ka parashtruar padi me propozim për lejim të ekzekutimit për borxhin të cilin i padituri ka pasur për shfrytëzimin e shërbimeve të telefonisë respektivisht të telefonit me nr. 622-236 për muajt 4, 5-11.2008.I padituri ka parashtruar kundërsëhtim në këtë propozim andaj çështja ka kaluar në procedurë kontestimore i cili propozim konsiderohet si padi.Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën e tij të fundit i autorizuari i paditësit ka ngelur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës nga padia me propozim që gjykata të obligoj të paditurin të paguaj borxhin për shfrytëzimin e telefonit si në propozim për përmbarim në shumë prej 91.82 € me kamatë ligjore prej 3,5%, bazuar në faturat e PTK-ës parashtruar me padi për muajt të lartcekur. I ka kërkuar shpenzimet procedurale sipas vlerësimit të gjykatës.

I autorizuari i të paditurit në përgjigje në padi, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën e tij të fundit në tërësi e ka kontestuar padinë dhe kërkesë padinë duke cekur se kemi të bëjmë me parashshkrimin e përgjithshëm të borxhit.Obligimi i të paditurit për pagesë të telefonit rrjedh që nga viti 2008 dhe bazuar në nenin 360 par.1 pika 3 të Ligjit mbi marrdhëniet detyrimore kërkesat e Postës dhe e kompanive të telefonit parashkruhen në afat prej 1 viti si dhe bazuar në nenin 352 të LMD kërkesat parashkruhen për 5 vjet duke llogaritur nga dita e arritjes së pagesës së kërkesës, andaj pasi që kemi të bëjmë me kërkesa periodike bazuar në të lartcekurat konsiderojmë se padia

respektivisht kërkesë padia e paditësit duhet që të refuzohet për shkak të parashkrimit të përgjithshëm. Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas vlerësimit të gjithë provave të gjitha veç e veç dhe së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK ka gjetur se kërkesë padia e paditësit është e BAZUAR.

#### *Vlerësimi i provave*

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike i ka administruar këto prova ka bërë shiqimin në faturat e PTK në emër të S E për muajin 04.2008 me dt. 09.05.2008, për muajin 06.2008 me dt. 07.07.2008, për muajin 07.2008 me dt. 07.08.2008, për muajin 08.2008 me dt. 04.09.2008, për muajin 09.2008 me dt. 03.10.2008, për muajin 10.2008 me dt. 06.11.2008 dhe për muajin 11.2008 me dt. 03.12.2008.

Nga leximi i të gjitha këtyre faturave është konstatuar se për muajin e 4.2008 i padituri borxh ka pasur 32,65€, për muajin e 6.2008 48.98€, për muajin e 7.2008 12.78€, për muajin 08.2008 15.03€, për muajin e 09.2008 6.57€, për muajin 10.2008 3.99€, dhe për muajin e 1.2008 1.68€. Nga këto fatura shihet se i padituri pjesërisht ka paguar borxhin por se borxhi total me dt. 03.12.2008 është 91.82€.


#### *Vlerësimi juridik*

Gjykata në rastin konkret ka vërtetuar këtë gjendje faktike nuk është kontestuese se i padituri i ka shfrytëzuar shërbimet e Postës së Telekomit të Kosovës respektivisht e ka shfrytëzuar telefonin statik me nr.622-236 në vitin 2008. Nuk është kontestuese se bazuar në faturat i padituri edhe pse nuk ka prova shihet se një pjesë të borxhit e ka paguar por në fund të vitit 2008 respektivisht me dt. 03.12.2008 figuron borxhi gjithsejt 91.82€ pasi që me këtë datë linja telefonike ka qenë në procedurë të demontimit respektivisht prej asaj dite është demontuar. I padituri është thirrë në parashkrim bazuar në nenin 360.1.3 të LMD që kanë të bëjnë me pagesat dhe parapagimin e kërkesave periodike duke konsideruar se të njëjtat janë parashkruar bazuar në nenin 354.2 të LMD duke pretenduar se kërkesat periodike parashkruhen për 5 vjet duke llogaritur nga arritja e pagesës së kërkesës më të vjetër të papërbushur pas së cilës debitori nuk ka kryer dhënie por gjykata bazuar në nenin 369 të LMD-ës e cila cek se parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimit të kërkesës konsideron se paditësi me parashtrimin e propozimit për përmbarim me dt. 03.03.2009 e ka ndërprerë parashkrimin dhe me këtë edhe nuk mund të konsiderohet se kërkesa respektivisht e drejta në kërkesën dhe përmbushjen e borxhit është parashkruar. Paditësi përveç borxhit kryesor ka kërkuar që i padituri të paguaj edhe kamatën ligjore andaj gjykata në kuptim të nenit 378 të LMD-ës e ka obliguar të paditurin që të paguaj edhe kamatën që nga marrja e aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar në kuptim të nenit 452.1 LPK pasi që pala e cila humb kontestin obligohet që palës tjetër t'i shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**C.nr.252/12 të dt.21.08.2014**



**Gjyqtarja**

**Shpresa Emra**

**KËSHILLA JURIDIKE;** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.